



Republika e Kosovës



Komuna- Vushtri

**PLANI I PUNES  
SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2010**

Janar 2010

## Hyrje

Plani i punës së Kryetarit të komunës është i bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 30/L-040 dhe Statutin e komunës me të cilat janë të përcaktuara kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të komunës. Mbi bazën e këtij legjislacioni si dhe të programit të subjektit politik PDK, të prezantuar para elektoratit të komunës së Vushtrrisë i cili i ka dhënë mbështetje këtij programi dhe mua si kryetarë i komunës, është hartuar ky plan i punës i cili përmban bazën për një zhvillim të mirëfilltë ekonomik të komunës, për të përmirësuar kushtet e jetesës së qytetarëve.

### **Prioritetet bazë mbi të cilat synohet zhvillimi i komunës:**

- 1. Përmirësimi i infrastrukturës ekonomike dhe sociale*
- 2. Rritja e të hyrave buxhetore të komunës dhe menaxhimi i efektiv dhe transparent i buxhetit*
- 3. Përmirësimi i ambientit për komunitetin e biznesit*
- 4. Tërheqja e investimeve të huaja*
- 5. Shtimi i punësimit dhe gjenerimi i të ardhurave*
- 6. Rritja e prodhimit të bujqësorë dhe përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve*
- 7. Zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore si dhe mbrojtja dhe menaxhimi efektiv i mjedisit*

## **1. EKONOMIA**

### Prioritetet;

#### **1. PERMISIMI I INFRASTRUKTURES EKONOMIKE DHE SOCIALE**

- Si parakusht i zhvillimit ekonomik infrastruktura ka një vend të merituar në orientimin dhe tërheqjen e investimeve në Komunë,
- Për vitin 2010 për investime kapitale janë planifikuar mjete buxhetore në shumë prej 3,028,201.00.

#### **2. RITJA E TË HYRAVË BUXHETORE DHE MENAXHIMI EFEKTIV DHE TRANSPARENT I BUXHETIT**

- Kjo do të realizohet përmes rritjes së shkallës së efikasitetit në punë për rritjen e shkallës së të hyrave buxhetore përkatësisht
- Gjetjen respektivisht shfrytëzimin e burimeve financiare - përmes donacioneve apo formave tjera

### 3. PERMISIMI I KUSHTEVE PËR KOMUNITETIN E BIZNESIT

- Krijimi i kushteve me te favorshme për zhvillimin e biznesit
- Përkrahjen e komunitetit të bizneseve të vogla dhe të mesme përmes promovimit të politikave tatimore stimulative për krijimin e lehtësirave për biznes.
- Diversifikimi i të ardhurave përmes NVM-ve (Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) dhe përpunimit të prodhimeve lokale natyrore
- Ndërtimi i Parkut të biznesit në Lumadh

### 4. TËRHEQJA E INVESTIMEVE TË HUAJA

- Krijimin e infrastrukturës së domosdoshme për tërheqjen e investimeve të jashtme dhe të brendshme

### 5. SHTIMI I PUNËSIMIT DHE GJENERIMI I TË ARDHURAVE

- Fortësimi dhe stimulimi i sektorit privat për të rritur aktivitetet ekonomike – rritjen e punësimit dhe zvogëlimin e varfërisë.

## **2. BUJQËSIA**

### Prioritetet;

- Rritja e prodhimit të Bujqësore dhe përmirësimi i produkteve bujqësore të prodhimeve bujqësore
- Zhvillimi i bujqësisë bashkëkohore përmes përmirësimit të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit
- Përmirësimi i infrastrukturës për ujë
- Zhvillimi i infrastrukturës rurale, në veçanti ujë të pijes, kanalizimit dhe kushteve të jetesës në familjet rurale
- Zbatimi i planifikimit hapësinor për përmirësimin e menaxhimit të tokës

Bazuar në resurset ekzistuese, si dhe në punën për identifikimin e nevojave imediate të fermerëve, janë adresuar këto prioritetet të përgjithshme:

- Zhvillimi dhe avancimi i mëtutjeshëm i bujqësisë intensive, nga prodhimi primar deri në përpunim;
- Menaxhimi i mirë i tokës bujqësore;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i ambientit në raport me resurset natyrore të komunës ujërat, pyjet, kullosat
- Themelimi i Drejtorisë Komunale të Bujqësisë dhe rritja e kapaciteteve planifikuese të stafit të saj;
- Puna në fuqizimin e shërbimit këshillimor bujqësor-rural;

- Edukimi dhe aftësimi profesional i fermerëve dhe krijimi i rrjetit informativ për fermerë;
- Diversifikimi i të ardhurave në viset kodrinore-malore;
- Themelimi i Entit Kombëtar të Patates;

Duke u angazhuar seriozisht në përmbushjen e prioriteteve të përmendura më lartë synojmë që përmes planifikimit adekuat, pastaj politikave aktive stimuluese dhe përkrahëse të krijojmë mundësi reale për intensifikimin e bujqësisë që do të reflektohet përmes rritjes së prodhimit dhe profitabilitetit..

Rritja e rendimenteve në kulturat kryesore bujqësore përmes arsimimit dhe edukimit profesional të fermerëve, zbatimit të teknikave të reja prodhuese dhe teknologjisë bashkëkohore dhe këmbimit të eksperiencave.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe ngritjes së plantacioneve të pemëve sidomos mollës, kumbullës dhe dredhëzës.

Do të ketë një promovim aktiv të resurseve bujqësore të komunës sonë duke shfrytëzuar përparësitë krahasuese.

Përmes krijimit të bazës së të dhënave për fermerët e komunës do të mundësohet një menaxhim efektiv i skemës së subvencioneve qeveritare dhe atyre komunale.

Përmes themelimit të Entit Kombëtar të Patates synojmë që Vushtrinë ta shëndërrojë në 'komunë të patates'. Në fakt me kultivimin e rreth 1200 hektarëve me patate për çdo vit (dhe e cila sipërfaqe mund të rritet akoma më shumë) dhe me themelimin e këtij institucioni do të rrumbullaksohet definitivisht procesi në të cilin traditës, përvojës dhe potencialeve i bashkangjitet edhe shkenca dhe zbatimi i plotë i të arriturave shkencore në këtë prodhimtari.

### **3. FINANCA**

Për menaxhimin e financave publike do të përqendrohemi në :

- Menaxhim të mirëfilltë të buxhetit të komunës konform Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, dhe Ligjit për financat Lokale,
- Transparencë në financa publike ku qytetarët do të kenë çdoherë qasje në shfrytëzimin e parasë publike

- Shpenzimi i buxhetit të Komunës do të bëhet konform planifikimit buxhetor.

Sa i përket planifikimit të buxhetit do të kërkojmë që ndarja e mjeteve financiare nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për Komunën tonë të bëhet konform rregullave dhe kritereve të ndarjes së buxhetit për buxhete Komunale, (problemi qëndron se komuna e jonë me rastin e ndarjes së grantit nga MEF që nga viti 2002, ndarja e grantit ndahet vetëm për 75000 banorë kurse në bazë të disa të dhënave statistikore Komuna e Vushtrrisë ka mbi 105000 banorë).

#### PLANIFIKIMI I PROJEKTEVE KAPITALE PËR VITIN 2010

-	Vlera e projekteve kapitale për vitin 2010 është 3,028,201.00 Euro, prej të cilave nga;	
-	Granti qeveritar-----	1,995,776.00
-	Të hyra vetanake(pk)-----	1,105,000.00
<hr/>		
-	Totali -----	3,028,201.00 €

Konkludim: Për realizimin e projekteve të planifikuara kapitale ekzistojnë mjetet e ndara buxhetore që donë të thotë se kërkesat për projekte të planifikuara janë të ballansuara me sigurimin e mjeteve buxhetore në përputhje të plotë me planifikimin buxhetor përkatësisht shfrytëzimin e buxhetit për vitin 2010, që do të paraqitet në tabelarët në vijim:

#### **4. PROKURIMI**

##### Prioritet

- Zbatimi i legjislacionit në fuqi që rregullon procedurat e prokurimit publik e që konsistojnë në
- Procedurë të hapur dhe transparente, vlerësim objektiv dhe marrje të vendimeve konform rregullatives ligjore, në mënyrë transparente dhe të pa anshme për të gjithë operataorët ekonomik,
- Trajnimi i personelit në drejtorinë e prokurimit etj.

#### **5. SHERBIMET PUBLIKE**

##### Prioritetet

- Furnizimi i qytetarëve të komunës me ujë të pijshëm (ndërtimi i një fabrike për përpunimin e ujit të pijes me kapacitet prej 350 (l/s),
- Përkrahja teknike dhe financiare e iniciativave për ndërtimin e rrjetave primare dhe sekondare të ujësjellësve nëpër Bashkësitë Lokale
- Përkrahja teknike dhe financiare e iniciativave për ndërtimin e rrjetave primare dhe sekondare të kanalizimeve nëpër Bashkësitë Lokale
- Ndërtimi i infrastrukturës sipas KAB ( Korniza Afatmesme Buxhetore) 2010-2014
- Ndërtimi i Kolektorit të ujërave të zeza buzë lumit Silnica
- Ndërtimi i një Impianti për trajtimin e ujërave të zeza
- Asfaltimet të reja në qytet dhe fshatra
- Ndërtimi i rrugëve në kubëza ,trotuareve dhe parkingjeve publike
- Gjelbërimi i qytetit , oborreve shkollore, qendrave të mjekësisë familjare, varrezave dhe mirëmbajtja e tyre
- Pastrimi i rrugëve dhe shesheve në qytet si dhe menaxhimi i mbeturinave.
- Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tij
- Sinjalizimi i rrugëve dhe mirëmbajtja e tyre
- Caktimi i lokacionit për parking të Auto-taxi-ve në qytet

#### **6. EMERGJENCA**

##### Prioritetet:

- Identifikimi dhe analiza e problemeve të lidhura me fatkeqësitë natyrore
- Hartimi dhe azhurimi i planit për mbrojtje dhe shpëtim
- Organizimi i seminareve me subjektet në tere
- Sensibilizimi i popullatës për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë elementare, mbrojtje nga fatkeqësit natyrore
- Evidentimi dhe sistemimi i resurseve njerëzore dhe mjeteve materiale-teknike për nevoja emergjente

## **7. ADMINISTRATA PUBLIKE E KOMUNËS**

### Prioritetet :

- Ngritja e Përgjegjësisë dhe disiplinës në punë në nivelin më të lartë të mundshëm e cila do të arrihet me implementimin praktik të akteve normative
- Avancimi i efikasitetit në punë
- Përgatitja e materialeve duke dhënë propozimet dhe rekomandimet për shqyrtim dhe aprovim të atyre materialeve në mbledhjet e KPF dhe KK. si dhe materializimi dhe implementimi i vendimeve që do të merren në ato mbledhje.
- Përgatitja dhe organizimi i mbajtjes së tubimeve publike me qytetarët
- Ndërtimi i objektit të ri Komunës i cili do t'i plotësonte nevojat e punëtorëve si dhe qytetarit do i ofroheshin shërbime më cilësore. Kjo do të jetë e ndërlidhur me mundësinë e sigurimit të mjeteve financiare pasi që ndërtimi i këtij objekti do të ketë kosto të lartë financiare.
- Shqyrtimi i mundësive për hapje të zyrave lokale në qendra kryesore - BL
- Aftësimi dhe trajnimi i personelit ekzistues dhe plotësimi i vendeve të lira të punës me kuadro me përgatitje adekuate profesionale.
- Hapja e Qendrës për regjistrimin e automjeteve në Vushtrri.

*Realizimi i këtyre projekteve në administratën e Komunës do të ndikoj në ngritjen e efikasitetit në punë dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.*

## **8. URBANIZMI**

### Prioritet:

- a. Zbatimi I PZHK dhe PZHU dhe jetësimi i tij
- b. Hartimi i planeve rregulluese në territorin e qytetit të Vushtrrisë, gjithsej 17 plane rregulluese
- c. Hartimin e planeve zhvillimore dhe urbane për qendrat sekondare në bazë të PZHK PËR
  - Pantinë
  - Novolan
  - Maxhunaj
  - Samadrexhe
  - Prelluzhë

Në bashkëpunim të ngushtë me drejtorinë e Inspektionit të ndërpriten ndërtimet ilegale dhe të zbatohet Plani Zhvillimor Komunal ( PZHK) dhe Plani Zhvillimor Urban (PZHU)

Te modifikohet rregullorja për legalizimin e ndërtimeve pa leje e v. 2002 dhe të aplikohet Manuali për legalizim e objekteve pa leje i mbështetur nga Asociacioni i Komunave të Kosovës gjer në aprovimin e Ligjit për Legalizim.

Në kuadër të Drejtorisë të stimulohet plotësimi me kuadro profesionale për formimin e një zyreje për hartimin e detyrave projektuese të projekteve dhe mbikëqyrjes së tyre gjatë realizimit,

Hartimi i një rregulloreje komunale që organet mbiqyrese të stimulohen materialisht në bazë të një përqindje të caktuar nga projekti i cili menagjohet.

d. Formimi i një zyreje për projektme

Kjo zyrë do të merrej me hartimin e detyrave projektuese për të gjitha projektet kapitale të komunës në bazë të të cilave do të punoheshin projektet detaje nga firmat e licencuara, si dhe do të mbikëqyrte projektet kapitale.

### **Formimi i këshillit komunal për zhvillim**

Me PZHK është parapa themelimi i Këshillit Komunal për Zhvillim i cili do të ketë për obligim krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik në zonën buzë magjistrales, gjithashtu ky këshill do të organizonte informime dhe këshillime me investues privat gjatë promovimit të partneritetit të pronës private me atë publike.(neni 5.2.3 Dispozita për zbatim i PZHK)

## **9. KADASTRI DHE GJEODEZIA**

### **Prioritetet:**

1. Kompletimi i rrjetit gjeodezik rendi i III
2. Digjitalizimi i lëndëve të Komacsonit
3. Përfundimi i lëndëve të Komacsonit
4. Zbatimi i Kadastarit etazh
5. Regjistrimi i ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave
6. Regjistrimi i përvojave ajrore dhe nëntokësore
7. Shpronësimi i pronave private (sipas nevojës) me rastin e realizimit të projekteve me interes të përgjithshëm
8. Lirimi i pronave Komunale dhe pronave Publike nga uzurpuesit
9. Rritja e efikasitetit nga ana e Organit për realizimin e kërkesave të palëve



## **10. SHËNDETSIA**

### **Prioritetet:**

- Ndërtimi i një Qendre Kryesore të Mjekësisë Familjare ne qytet (perball Kop. Bujqësore) ;
- Ndërtimi i QMF në Beqiq, dhe Pasomë;
- Ndërtimi i rrethojës së ambulancës në Nevolan,
- Ndërtimi i rrethojës së ambulancës në Nevolan,
- Ndërtimi i rrethojës së ambulancës në Ashlan,
- Ndërtimi i rrethojës së ambulancës në Druar,
- Ndërtimi i rrethojës së ambulancës në Stroc,
- Gjelbërimi i ambientit nëpër të gjitha ambulancat;
- Pajisja me inventar për QKMF e re;
- Pajisje me mjete mjekësore për QKMF e re;
- Furnizimi me teknologji informative;
- Vazhdimi i renovimit të Qendrave Mjekësore në vendet rurale ,atje ku është e domosdoshme ;
- Vizitat sistematike të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme ,për zbulim të hershëm të sëmundjeve
- Kujdesi parësor shëndetësor, nëpërmes Ekipit të Mjekësisë Familjare
- Prioritetet për shërbimet preventive ;

## **11. MIRËQENIA SOCIALE**

### **Prioritetet:**

- Ndërtimi i një objekti social, për vendosjen e familjeve të rrezikuara në pikëpamje banimit. Për këtë do të insistohet në gjetjen e mjeteve nga donator të mundshëm,
- Ndarja e një buxheti për personat dhe familjet në gjendje të rëndë sociale në raste emergjente
- Mbështetja e fëmijëve pa kujdes prindor
- Mbështetje të familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidëve, veteranëve dhe viktimave të luftës
- Përkujdesja për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare përmes QPS
- Trajtimi profesional i kategorive të mbrojtjes sociale,
- Parandalimi i delikuencës dhe sjelljeve asociale tek të miturit dhe të rinjtë,
- Integrimi i personave me çrregullime në sjellje,
- Formimi i Komisioneve për çështje sociale në nivel të BL,
- Orientimi i punës sociale në shëndetësi (përmes infermierisë në komunitet sidomos për personat me gjendje të rëndë shëndetësore

dhe pa përkujdesje familjare, aplikimit të zonimit -çdo mjek ta ketë zonën e vetë të përkujdesjes shëndetësore

- Sigurimi i shujtës sipas mundësisë në shkollë fëmijëve me gjendje të vështirë materiale
- Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara përmes shërbimeve shëndetësore falas, zhvillimit dhe fuqizimit të shoqatave të tyre, rregullimit infrastrukturës për lehtësimin e lëvizjes si përmes shtigjeve, parkingjeve etj.

## **12. INSPEKTORATI**

### **Inspektorati i tregut**

- Inspektimi i afarizmit tregtar të bizneseve
- Kontroll mbi prejardhjen e mallrave dhe afatet e produkteve
- Tek transportuesit e mallrave gjegjësisht tek shitësit lëvizës kontroll mbi faturat përcjellëse të mallit si dhe faturat e shitjes
- Do të përcillet fillimi i punës të firmave të reja si dhe ato që mbyllen.
- Puna me palë me orar të caktuar me qëllim të këshillimit, edukimit vërejtjeve etj. për një tregti sa më reale

### **Inspektorati i Ndërtimit**

- Rëndësi e veçante do ti kushtohet zbatimit të planit urban të qytetit ne bashkëpunim me drejtorinë për Urbanizëm, pastaj
- Angazhimet për Legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje atu ku lejohet legalizimi
- bashkëpunimit me qytetar dhe informimi i tyre për rendësin e lejes se ndërtimit
- Do te ndërmerren masa për ndalimin e ndërtimeve pa leje ne komunë

### **Komunikacioni rrugor**

- Mbikëqyrja e kompanive (firmave) si dhe të gjithë operatorëve që merren me veprimtarinë e transportit të udhëtarëve,
- Mbikëqyrjen e mbajtjeve të vijave urbane (lokale) si dhe ato ndër urbane.
- Inspektimi i Auto – transportuesit që kryejnë transportimin e mallrave.
- Inspektimi i Auto – taxi-ve të udhëtarëve.

### **Mbikëqyrja sanitare**

- Inspektimi i bizneseve lidhur me kualitetin e mallit, pastaj lidhur me
- Mbikëqyrjen e kontrollit të kushteve sanitare-higjienike

- Kontrollin e prodhimit dhe të qarkullimit të artikujve ushqimor dhe të gjërave të përdorimit të përgjithshëm.
- Kontrollin mujor të kualitetit përkatësisht cilësisë së ujit të pijes
- Gjendjen shëndetësore të personave të cilët punojnë në punët të cilat mund të rrezikojnë shëndetin njerëzorë.

### **Higjiena komunale**

- Mbajtja e pastërtisë dhe të higjienës në qytet
- mbajtja e pastërtisë së rrugëve, pastrimin e bores gjatë dimrit në sipërfaqet e parkingut, tregjeve, stacionit të autobusëve dhe ato të benzinës në oborre dhe varrezave..
- sipërfaqeve të gjelbëruara publike, terrenet sportive etj.
- Mbikëqyrja e hapësirave publike ,ekspozimin e mallrave ,shitja në rrugë
- Marrja e masave ligjore për parandalimin e këtyre dukurive etj.

### **Mbrojtja e mjedisit**

- Aplikim te standardeve të kualitetit në të gjitha aktivitetet që kanë ndikim në ambient,
- Mbikëqyrja e implementimit të masave të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit si dhe respektimin e ligjit në pajtueshmëri me programin për mbrojtjen e mjedisit,
- mbikëqyrja dhe aplikimi i masave për mbrojtjen e zonave të mbrojtura të natyrës,
- Përgatitja e programeve për pyllëzim të sipërfaqeve të ç'veshura

### **Produktet Bujqësore**

- kontrollimin e produkteve bujqësore,
- mbikëqyrjen e barnatoreve bujqësore,

## **13. ARSIMI**

### **Prioritetet:**

- Përmirësim të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënjes duke krijuar kushte optimale për mësim hapësirë te mjaftueshme, mjete konkretizimi,
- Subvencionimi i studimeve për studentet e drejtimeve deficitare dhe atyre me gjendje të rënd sociale
- Përfshirje e te gjitha moshave dhe gjinive në mësimin gjatë gjithë jetës ne jetën praktike.

- Ngritja e kapaciteteve te reja ne infrastrukturën shkollore, ndërtimi i shkollave te reja ne qytet ne kthimin normal të punës me dy nderime me një ore mësimore normale për zhvillimin e aktiviteteve të parapara sipas planit të orës.
- Sigurimi i ambientit të shendosh për nxënës dhe personelin shkollor.
- Aftësimi dhe rikualifikimi i stafit arsimorë.
- Meremetimi i shkollave ekzistues,
- Furnizimi me ujë mjaftueshëm për pije edhe për mirëmbajtjen e kopshteve shkollore
- Sigurimi i transportit të nxënësve për viset rurale.
- Përfshirje të të gjithë nxënësve me aftësi të kufizuara

:Projektet prioritare

PROJEKTET E NDERTIMIT TË SHKOLLAVE

	Shkolla	vendi	Projekti	Investimet
1	SHKOLLË E MESME E PERGJITHSHËM	Vushtrri	24 klasa	2.000.000
2	Shkollë e re dhe SHMU	Zhilivodë	5 klasa	20.000
4	Shkollë e re dhe SHMU	Bukosh	8 klasa	300000
7	Shkollë e re dhe SHMU	Karaqë	5 klasa	20000

PROJEKTET E MEREMETIMIT TË SHKOLLAVE

	Shkolla	Vendi	Projekti	Investimet
1	Gjimnazi “Eqrem Çabej”	Vushtrri	Ndërrimi i dyshemesh	
			Ndërrimi i dyerve dhe dritareve	
2	SHMT “Lutfi Musici”	Vushtrri	Ndërrimi i dyshemesë	
			Ndërrimi i dyerve dhe dritareve	
			Meremetimi i kulmit të shkollës	
3	“Lumni Surdulli”	Samaderxhë	Ndërrimi i	

			dyshemesë	
			Ndërrimi i dyerve dhe dritareve	
			• Paralelet parashkollor	
4	Rilindja	Maxhunaj	Meremetim i plotë	
			• Paralelet parashkollor	
		Pestovë	Fushë sportive	
			Rrethoja dhe gjelbërimi i hapësirës shkollore	
			*Paralelet parashkollor	

Do të bëhet gjithashtu edhe rregullimi i rrethojave të shkollave dhe objekteve ndihmëse nëpër shkolla.

#### **14. KULTURË RINI DHE SPORT**

##### Prioritetet;

- Renovimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit i cili do të mund të shfrytëzohet për muze, arkiv, galeri dhe bibliotekë,
- Organizimi i mbajtjes së manifestimeve kulturore të komunës, (Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, Akademia përkujtimore e 2 dhe 22 majit, Takimet e poeteshave Shqiptare, Dita e Çlirimit, dita e dëshmorëve, dita e Flamurit kombëtar etj.
- Krijimi i kushteve për aktivitete kulturore,

##### **Rinia**

Kosova është vendi me popullsi më të re në Evropë dhe perspektiva e Kosovës është një rini e shëndoshë dhe e aftë për tu përballë me sfidat dhe të arriturat e kohës. Në këtë kuadër do të angazhohemi;

- në arsimim dhe edukim sa më të mirë të rinisë në mënyrë që të jetë e aftë për tu integruar në botën bashkëkohore e kjo do të arrihet vetëm duke ju krijuar kushte dhe mundësi që të integrohen në shoqëri si kulturë, arsim, sport, ekonomi, politikë, etj,
- do të krijohen mundësi për ndjekje të kurseve, seminareve dhe trajnimeve të ndryshme me qëllim të ngritjes profesionale dhe një aftësim sa më bashkëkohorë dhe profesional të tyre.

- Sensibilizimi i rinisë për rreziqet nga bartja e armëve, fatkeqësitë në trafik etj. Arritja e këtyre objektivave nënkupton inicimin, organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve arsimore, rinore, sportive, edukuese etj.
- Edukimi i të rinjve për një ambient të shëndetshëm, i abuzimit të substancave narkotike, alkoolit dhe duhanit,
- Organizimi i programeve dhe trajnimeve për rini (informatikë, gjuhë të huaja, shëndetësi, art, udhëheqje), etj
- Subvencionimi i studenteve me bursa
- Përkrahja dhe inkurajimi i OJQ-ve rinore duke ju ndihmuar në realizimin e aktiviteteve
- Organizimi i debateve të ndryshme me dhe për rininë etj.

## **Sporti**

Ndër prioritetet kryesore që do të realizohen ;

1. Subvencionimi i klubeve Sportive,
2. Renovimi i fushës së hendbollit,
3. Krijimi i mundësive që përmes trajnimeve dhe seminareve të ndryshme të bëhet profesionalizimi dhe të rritja e cilësisë së klubeve,
4. Mirëmbajtja e objekteve dhe terreneve sportive
5. Organizimi dhe mbikëqyrja e organizimit të garave sportive komunale të nxënësve të shkollave fillore dhe atyre të mesme

## **15. ZYRA PËR INTEGRIME EUROPIANE**

### Prioritetet:

Do të përqendrohet në përmbushjen e obligimeve të cilat dalin nga dokumenti “Plani për implementimin e Partneritetit Evropian” si dhe të gjitha obligimet tjera nga vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve tjera gjegjëse të lidhura me procesin e integrimeve evropiane. Kjo do të realizohet në bazë të prioritetëve të përcaktuara, ku do të përcillet permanent, realizimi i prioritetëve.

## **16. ZYRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

### Prioritetet:

- Fuqizimi i rolit të gruas në komunë,
- Organizimi i tryezave me OJQ e ndryshme
- Organizimi i seminareve për komunitetet e ndryshme me temën njohja dhe forcimi i kontakteve në mes të komuniteteve etj.

## **17. AUDITIMI I MBRENDSHËM**

### **Prioritetet**

- Funksionimi dhe analiza e kontrolleve të brendëshme në të gjitha nivelet e komunës
- Auditimi i rregullt sipas planit vjetor
- Sipas nevojës, edhe auditime të jashtëzakonshme,
- Pjesëmarrje në trajnime të auditëve dhe ngritje e vazhdueshme profesionale.

## **18. ZYRTARI (PËRFAQËSUESI) LIGJOR I KOMUNËS**

Aktivitetin e vet do ta orientoj në;

- Angazhimin për zbatimin e ligjshmërisë në komunë,
- Kujdesin dhe mbrojtjen e pronës përkatësisht pasurisë së komunës si dhe
- Të ndërmer masa tjera të parapara me ligj, për mbrojtjen e interesit të komunës.

### **Përfundim**

Në suaza të kompetencave të cilat janë përcaktuar me ligjet rregulloret dhe aktet tjera juridike në fuqi, unë s' bashku me qeverinë komunale do të angazhohem maksimalisht në përmbushjen në tërësi të detyrave të përcaktuara me këtë plan të punës, në planet e drejtorëve të drejtorive komunale dhe të atyre çështjeve të cilat nuk kanë mundur të përfshihen në këtë plan.

Me shprehjen e mendimeve, sygjërimeve dhe propozimeve që do të mund të paraqiten nga këshilltarët komunal në mbledhjen e kuvendit kur do të prezantohet ky plan, i njëjti do të mund të plotësohet duke marrë parasysh ato sugjerime në mënyrë që ky plan të jetë sa më i gjithëpërfshirës.

Kryetari i Komunës

**Bajram Mulaku**